



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO

Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivery	01.06.2023	viti god year	3
Organ /Njesia Organ /Jednica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
KSPMHCV	4564/2023		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.654/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtare, dhe Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr 654/2023 të datës 19.04.2023 të parashtruar nga ankuesja me adresë fshati Hoçë e Vogël në Komunën e Rahovecit, kundër masës disiplinore Vërejtje të shqiptuar nga Drejtori i Qendrës për Punë Sociale, në çështjen juridike "masë disiplinore", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 31.05.2023 mori këtë:

V E N D I M

- I. Aprovohet ankesa me numër A.nr.654/2023 e datës 19.04.2023 e parashtruar nga ankuesja
- II. Anulohet masa disiplinore „Vërejtje” me numër referencë 38/2023 e datës 24.03.2023 të shqiptuar nga Drejtori i Qendrës për Punë Sociale.
- III. Obligohet Kryetari i Komunës dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Rahovecit, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, të bëjë zbatimin e këtij vendimi duke bërë shuarjen e masës disiplinore ndaj ankueses në pajtim me këtë vendim.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ankuesja e punësuar në Komunën e Rahovecit sipas Akt Emërimit AE.Nr.397/2021 të datës 28.04.2021 në pozitën "Zyrtare për Shërbime Sociale", me datën 23.03.2023 rreth orës 15: 30 njoftohet përmes emailit nga Udhëheqësja e Sektorit për Shërbime Sociale në cilësinë mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të saj se me kërkesën e Stacionit Policor në Rahovec si

zyrtare kujdestare duhet që të asistoj sipas planifikimit të aksionit policor. Ankuesja përmes emalit të datës 23.03.2023 ka njoftuar Drejtorin e Qendrës për Punë Sociale që për shkaqe shëndetësore nuk është e gatshme të dal në teren që të asistoj dhe me po të njëjtën emali është njoftuar edhe udhëheqësja e drejtpërdrejt e ankueses respektivisht Udhëheqësja e Sektorit për Shërbime Sociale .

Drejtori i Qendrës për Punë Sociale me datën 24.03.2023 ka marr Vendimin me numër protokollit 38 me të cilin ankueses i ka shqiptuar masën disiplinore "Vërejte" me arsyetim se ankuesja nuk ka zbatuar urdhrin e Drejtorit të Qendrës për Punë Sociale që me datën 23.03.2023 për t'ju bashkangjitur aksionit të përbashkët të Policisë së Kosovës dhe QPS në Rahovec, me arsyetimin se ka shqetësime shëndetësore ndërsa e njëjta nuk ka arritur ta dëshmojë me dokumentacion që ka probleme shëndetësore dhe se para se të marr urdhrin nga drejtori, nuk ka treguar asnjë shqetësim sa i prektë shëndetit të saj ngase nuk ka kërkuar leje që të shkojë te mjeku.

Ankuesja e pa kënaqur me vendimin me numër të protokollit 38 të datës 24.03.2023 të Drejtorit të Qendrës për Punë Sociale me datën 19.04.2023 ka parashtruar ankesën me numër protokollit 3670/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës , me pretendim ankimor se në vendimin e datës 24.03.2023, ka vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjindes faktike, shkelje të dispozitave procedurale, si dhe shkelje të dispozitave materiale, pasi që e njëjta edhe pse nuk ka dalur për asistim gjatë kujdestarisë për shkak të gjendjes shëndetësore detyrat e saj janë plotësuar nga udhëheqësja e saj e cila po ashtu është pjesë e ekipit të kujdestarisë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 28.04.2023 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankueses nga Komuna e Rahovecit. Ndërsa Këshilli më datë 10.05.2023 ka pranuar përgjigjen në ankesë bashkë me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosien e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër të protokollit 3678 e datës 19.04.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin me e-mail të datës 23.03.2023 nga për ; Vendimin me nr.Ref 01/52/22 të datës 30.12.2022; Shtojcën Orari i kujdestarisë së Qendrës për Punë Sociale në Rahovec; Vërejtjen me numër referencë 38/2023 e datës 24.03.2023 të shqiptuar nga Drejtori i Qendrës për Punë Sociale; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 28.04.2023; Përgjigje në kërkesë të datës 10.05.2023; Akt Emërim me Nr.Ref 397/2021 të datës 28.04.2021; Përshkrimin e Detyrave të Punës për pozitën Zyrtare për Shërbime Sociale; E-mailin e datës 23.03.2023 nga për ; Vendimin me numër 2125-376 të datës 18.05.2022; Fleta përcjellëse me numër protokolloi 01-6/2023 të datës 13.03.2023; E-mail e datës 05.04.2023 nga për mail e datës 05.05.2023 nga për KPMSHCK-në; E-mailin e datës 23.03.2023 nga H. Troshupa për .

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosien e Ankesave, ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, dhe ka vërtetuar se ankesa e ankuesit, është e bazuar, sepse:

Nga administrimi i provave materiale të lëndës, ankuesja në bazë të Akt Emërimit AE.Nr.397/2021 të datës 28.04.2021 është e punësuar në pozitën "Zyrtare për Shërbime Sociale" në Komune e Rahovecit.

Kolegji i Këshillit në bazë të provave të dërguara nga ankuesja dhe organi i punësimit ka gjetur se Drejtori për Pune Sociale më datë 24.03.2023 ankueses i ka shqiptuar masën disiplinore "Vërejtje" me numër protokollit 38, me arsyetim që: "...ankuesja, nuk ka zbatuar urdhrin e Drejtorit të QPS që me datën 23.03.2023 për t'ju bashkangjitur aksionit të përbashkët të Policisë së Kosovës dhe QPS në Rahovec, me arsyetimin se ka shqetësime shëndetësore ndërsa e njëjta nuk ka arritur ta dëshmojë me dokumentacion që ka probleme shëndetësore dhe se para se të marr urdhrin nga drejtori, nuk ka treguar asnjë shqetësim sa i prehtë shëndetit të saj ngase nuk ka kërkuar leje që të shkojë te mjeku.

Bazuar në shkresat e lëndës të dërguara nga ankuesja dhe organi i punësimit Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se neni 46 paragrafi 4 i Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ka përcaktuar se cilat konsiderohen shkelje të lehta si: "mungesa e paarsyeshme në punë deri në dy (2) ditë pune; shkelja e rregullave të etikës; sjellja e parregullt, gjatë kohës së punës, me mbikëqyrësit, kolegët, vartësit dhe me publikun; kryerja e veprimeve, që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi, brenda ose jashtë orarit zyrtar", ndërsa neni 47 i këtij ligji ka paraparë masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil.

Kolegji i Këshillit ju referua Nenit 48 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili ka përcaktuar kompetencat për shqiptimin e masave disiplinore gjegjësisht paragrafi 1 i këtij neni i cili ka përcaktuar që: "Masa disiplinore e parashikuar në paragrafin 1.1 të nenit 47 të këtij ligji jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë", ndërsa neni 8 paragrafi 2 i Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, i cili përcakton se: "Masa disiplinore e përcaktuar në nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 i Ligjit jepet nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i nëpunësit civil, nëse nëpunësi ka bërë shkelje disiplinore të përcaktuara në nenin 46 paragrafi 4 nën paragrafi 4.1, 4.2, 4.3 dhe 4.4 të Ligjit", bazuar në këtë Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke i'u referuar nenin 47 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1, konstaton se masën disiplinore "vërejtje", ka kompetencë t'a shqiptoj vetëm mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i nëpunësit civil, kjo ndër lidhet me paragrafin 2 të nenit 48 të këtij ligji, i cili përcakton se: "Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë detyrohet të fillojë procedurën disiplinore mbi bazën e fakteve konkrete dhe të provuara për shkeljen e detyrimeve nga nëpunësi civil", në këtë rast ankuesja si "Zyrtare për Shërbime Sociale" në bazë të përshkrimit të detyrave të punës dhe Vendimit me numër 2125-376 të datës 18.05.2022 rezulton se si mbikëqyrës të drejtpërdrejtë ka znj .

U.d. e Udhëheqëses së Sektorit për Shërbime Sociale, si rrjedhojë, Kolegji vlerëson se Drejtori i Qendrës për Pune Sociale në Komunën e Rahovecit nuk ka pasur kompetencë për të shqiptuar ndaj ankueses masën disiplinore "vërejtje", sepse në bazë të provave materiale nuk është mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i ankueses dhe se i njëjti ka ndërhyrë direkt në kompetencat e mbikëqyrëses së drejtpërdrejtë të ankueses.

Bazuar në të lartcekurat, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se masa disiplinore „Vërejtje“ me numër protokollit 38 e datës 23.03.2023 e shqiptuar nga Drejtori për Pune Sociale ndaj ankueses është në kundërshtim me nenin 48 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, dhe 8 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë. Po ashtu masa disiplinore „Vërejtje“ e shqiptuar ndaj ankueses



është në kundërshtim edhe me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, konkretisht nenin 52 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, dhe si e tillë është e paligjshme, andaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton se pretendimet ankimore të ankueses janë të bazuara.

Meqenëse një akt administrativ i nxjerrë nga organi i cili nuk ka pasur kompetencë konsiderohet akt i paligjshëm sipas nenit 52 paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave nuk u lëshua në konstatimet e ligjshmërisë materiale të pretendimeve ankimore të ngritura në ankesë.

Si u tha më lartë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton se obligohet Kryetari dhe Udhëheqësi i Personelit i Komunës së Kamenicës, që në pajtim me dispozitivin e këtij vendimi të bëjnë shuarjen e masës disiplinore ndaj ankuesit në pajtim me këtë vendim.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në diapozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50 % të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.


Bazuar në këto rrethana, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.654/2023

Ilire MEHEMTI-SHAQIRI



Procesmbajtëse

Malsore-GASHI-BAJRAKTARI



Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankueses .
- Kryetarit të Komunës së Rahovecit;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Komunën e Rahovecit; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.